



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:240916

Datë: 23.04.2024

Numri i dokumentit: 05610930

**P.nr../..**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL** gjyqtari i vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrje të bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurit A.. V., për shkak të veprës penale kanosje nga neni 181 par. 2 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II nr.1444/23 të datës 07.11.2023, jashtë seancës gjyqësore me datë 23.04.2024 bie këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. APROVOHET** marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr../.. e datës 23.04.2024, lidhur në mes të pandehurit A.. V.. dhe të dëmtuarit D.. I. dhe përfaqësuesit të tij ligjor, S.. I. dhe S.. I. që të dytë me banim në fsh. K.. i R.. K. P...

**II. HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II nr.1444/23 të datës 07.11.2023.

**III. PUSHOHET** procedura penale ndaj të pandehurit A.. V., i lindur me datë ..., në K.. P.. tani me banim në fsh. K.. i R.. K. P.. nga i babai Sh.. e nënës Sh.. e gjinisë K., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mirë ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. prs....., posedon numër të telefonit ....., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

- për shkak të veprës penale kanosje nga neni 181 par. 2 të KPRK-së.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamentit të Përgjithshme me datën 26.10.2022 ka ngritur aktakuzën PP/II nr.479/23 të datës 18.10.2023 ndaj të pandehurit A.. V., për shkak të veprës penale kanosje nga neni 181 par. 2 të KPRK-së.

Me datën 23.04.2024 është arrit marrëveshja në zyrën e ndërmjetësimit në mes të pandehurit A.. V.. dhe te dëmtuarit D.. I.. dhe përfaqësuesit të tij ligjor, S.. I.. dhe S.. I.. që të dytë me banim në fsh. K.. i R.. K. P..., e cila marrëveshje i është dozuar gjykatës ne kopje të mjaftueshme.

Nga te cekurat me lartë gjykata ka vendosur si ne pikën I të dispozitiv të këtij aktvendimi duke e pranuar marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr../.. e datës 23.04.2024, lidhur në mes të pandehurit A.. V.. dhe te dëmtuarit D.. I.. dhe përfaqësuesit të tij ligjor, S.. I.. dhe S.. I.. që të dytë me banim në fsh. K.. i R.. K. P....

Me dispozitën ligjore të nenin 229 par. 5 të KPRK-së është përcaktuar se: nëse aktakuza është dorëzuar, gjyqtari i vetëm gjykues, nëse e pranon formalisht marrëveshjen, merr vendim për të hedhur aktakuzën dhe e ndërpre në procedurën penale.

Andaj nga të cekurat më lartë e në kuptim 229 par.5 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM ,  
DIVIZIONI PENAL  
2023:240916, 23.04.2024**

**Bashkëpunëtorja Profesionale**

**Gj y q t a r i**

\_\_\_\_\_  
Edona Berisha Kastrati

\_\_\_\_\_  
Musë Povataj

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate, në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi